



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.16 Regj.Them.
Datë Rregj.21.04.2023

Nr.16 VENDIMI
Dt.24.04.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Manjola XHAXHO	(Relatore)
Gjyqtar:	Sokol IBI	(Anëtar)
Gjyqtare:	Emona MUÇI	(Anëtare)
Gjyqtare:	Blerona HASA	(Anëtare)
Gjyqtare:	Marsela DERVISHI	(Anëtare)

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 24.04.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr.16 akti, datë 21.04.2023, me:

PADITËSE: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, me seli në Tiranë, Rr.“Donika Kastrioti”, Nr.3, përfaqësuar nga Z.Indrit Sefa.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar nga Znj.Pavlina Doçaj.

PERSON I INTERESUAR: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, me seli në Tiranë, Sheshi “Austria”, Nr.91, përfaqësuar me autorizim nga Av.Andi Skënderi dhe Av.Maringlen Legisi.

OBJEKTI:

- Shfuqizimi i Vendimit Nr.60, datë 19.04.2023 të KAS “Për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.49, datë 17.04.2023 të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë”
- Shfuqizimi i vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Shqyrtimin e kërkesës së partisë demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

- Ndalimin e kandidimit të Kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n", e 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Nenet 2 dhe 4 të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të Kreut V, pikat 5 dhe 12 të Vendimit nr.17/2016, të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse:

- pala paditëse kërkoi pranimin e padisë, sipas objektit;
- pala e paditur kërkoi rrëzimin e padisë;
- personi i tretë kërkoi rrëzimin e padisë.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse dhe në aktet provuese të dorëzuara në funksion të tyre:

VËREN

1. Rrethanat.

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Dekretit Nr.13864 Dt.24.10.2022, rezulton të ketë caktuar zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, në datën 14 maj 2023.

3. Subjekti politik "Partia Demokratike e Shqipërisë", bazuar në Vendimin Nr.179 Dt.18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, rezulton një ndër subjektet zgjedhore të regjistruara në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

4. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ) Nr.62, si organ i administratës zgjedhore kompetent për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të Bashkisë Mallakastër, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.4 Dt.28.03.2023, mbi: "*regjistrimin e kandidatit për kryetar z.Qerim Ismail Ismailaj në bashkinë Mallakastër, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023*".

5. Më datë 01.04.2023, rezulton të jetë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për kandidatin Qerim Ismail Ismailaj, Formulari i Vetëdeklarimit Nr.UNIK FR-PS-16657.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në Nenin 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, Nenin 33, shkronja "P" të Ligjit Nr.10019, Dt.29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Nenin 5, pika 4 shkronja "a" të Ligjit Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.300 Dt.05.04.2023 “Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, që konsiston në:

“-Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie, të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për disa bashki dhe lejimin e kandidimit të tyre.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

7. Më datë 06.04.2023, Partia Demokratike e Shqipërisë rezulton t’i ketë kërkuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve: *“verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z.Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar Bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Mallakastër”.*

8. Në mbështetje të pretendimeve, Partia Demokratike rezulton të ketë vënë në dispozicion të Komisionerit, Vendimin Nr.11 Dt.02.02.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që konsiston në:

“1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Qerim Ismailaj, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) muaj burgim;

2. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Qerim Ismailaj me 4 (katër) muaj burgim;

3. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurit Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, e cila do të përmbushet brenda afatit prej 6 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës”.

9. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.366 Dt.15.04.2023, që konsiston në:

“1.Mospranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike për mos lejimin e z.Qerim Ismailaj për të kandiduar si kandidat për kryetar në Bashkinë Mallakastër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z.Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për Bashkinë Mallakastër dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

10. Më datë 17.04.2023, Partia Demokratike e Shqipërisë rezulton të ketë ankimuar në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimin Nr.366 Dt.15.04.2023 të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve.

11. Kërkesa ankimore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, rezultoi të ishte bazuar në argumentin se:

“Z.Qerim Ismailaj ka deklaruar në formularin e tij të vetëdeklarimit të depozituar në KZAZ-në nr.62 një vendim gjyqësor, i cili në datën e deklarimit nuk kishte marrë ende formë të prerë në momentin e deklarimit;

- Në formularin e vetëdeklarimit, është shënuar nën kategorinë “masa e dënimit me burgim” përshkrimi “40 orë punë në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal”, i cili është një deklaram jo i vërtetë krahasuar me atë çka është përmbajtja e dispozitivit të vendimit të gjykatës nr.11, datë 02.02.2023. Z.Ismailaj ka ometuar të deklarojë se vendimi i gjykatës e ka deklaruar fajtor dhe e ka dënuar me burgim në masën 6 muaj;

- Referuar nenit 4, pika 9 të ligjit nr.138/2025, ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar(...), pezullimi i dënimit (...), nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji;

- Periudha e ndalimit për z. Ismailaj parashikohet në nenin 69 të Kodit Penal, që në rastin konkret është dy vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim;

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë një interpretim të gabuar të ligjit, duke i dhënë përparësi Kodit Penal përpara ligjit të posaçëm për dekriminalizimin”.

12. Seanca në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve rezulton të jetë zhvilluar në prani të subjektit zgjedhor Partia Socialiste Shqipërisë, i cili ka prapësuar se:

“- Z. Ismailaj në përfundim të gjykimit është dënuar me 40 orë punë të detyruar, dënim të cilin e ka ekzekutuar tashmë;

- Pas ekzekutimit të këtij dënimi, dënimi konsiderohet i paqenë dhe z. Ismailaj konsiderohet i padënuar;

- Duke qenë se ky dënim nuk cenon statusin juridik të z. Ismailaj, ai rezulton i padënuar në gjendjen e tij gjyqësore. Nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u zgjedhur një personi të padënuar”.

13. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.60 Dt.19.04.2023, që konsiston në:

“- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.49, datë 17.04.2023 të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

- Lënien në fuqi të vendimit nr.366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij”.

14. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve rezulton ta ketë bazuar vendimin, në argumentin se:

“1. Ankuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Indrit Sefa legjitimohet në të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.366, datë 15.04.2023, duke qenë se është pala që ka vënë në lëvizje procedurën administrative në cilësinë e kërkuetit.

2. Nisur nga objekti i saj, kërkesa ankimore nr.49, e datës 17.04.2023 e ankuesit Partia Demokratike e Shqipërisë hyn në sferën e kompetencës së KAS-it. Kodi Zgjedhor njeh ankimimin administrativ si mjet ligjor për mbrojtjen e interesave të ligjshme, sepse i ka njohur KAS-it kompetencën për të shqyrtuar dhe zgjidhur në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit (shkronja “ b ” e pikës 1 të nenit 21, pika 2 e nenit 124/1 të KZ).

3. Konfirmimin e kompetencës për ankimime që kanë lidhje me vendimmarrjen e Komisionerit në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KAS-i e ka kryer në dy vendime të mëparshme, në vendimin nr.07, datë 11.03.2021 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.04, datë 09.03.2021 të znj. Leonora Hyso ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.30, datë 15.12.2020” dhe në vendimin nr.53, datë 10.04.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.48, datë 07.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë””. Të dyja vendimet janë marrë me shumicë votash.

4. Kërkesa ankimore e depozituar nga ankuesi Partia Demokratike e Shqipërisë përbëhet nga dy parashtrës. Parashtrësja e parë konsiston në analizën dhe përcaktimin se kandidati për kryetar bashkie në bashkinë Mallakastër, z.Qerim Ismailaj, “nëpërmjet procesit të plotësimit të formularit të vetdeklarimit, ... ka konsumuar (përsëri) veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”. Kjo parashtrësja dhe çdo kërkim i lidhur me të nuk mund të merren në shqyrtim nga KAS-i, sepse dalin jashtë kompetencës së tij. Parashtrësja është, për nga përmbajtja dhe natyra, material për kallëzim penal. Kompetenca për trajtimin e saj i takon sistemit gjyqësor.

5. Parashtrësja e dytë ka lidhje me kërkesën për ndalimin e z.Qerim Ismailaj që të kandidojë, “për shkakun se sipas parashikimeve të ligjit nr.138/2015, “Për dekriminalizimin...” rezulton se bie brenda sferës së aplikimit të këtij ligji”. Pretendimi i paraqitur në parashtrësja është se “shtetasi Qerim Ismailaj është dënuar me 6 muaj burgim dhe se ky dënim është i formës së prerë”. Kjo rrethanë e vendos kandidatin për kryetar bashkie në kushtet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, “Për dekriminalizimin...”.

6. Ankuesi pranon faktin se kandidati për kryetar bashkie, z.Qerim Ismailaj është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimi i vulave, i stampave ose formularëve” dhe është dënuar me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, atij i është ulur 1/3 e dënimit dhe është dënuar përfundimisht me 4 muaj burgim, sikurse në aplikim të nenit 63 të K.Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim dhe është vendosur detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh.

7. Ankuesi pretendon se ulja e dënimit, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, dhe pezullimi i ekzekutimit të tij, në aplikim të nenit 63 të K.Penal, “nuk sjellin kurfarë efekti, ndaj parashikimit të nenit 2, pika “ç””, për shkak se pika 9 e nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, “Për dekriminalizimin...” nuk e lejon këtë gjë. “Për pasojë në asnjë mënyrë nuk mund të merren në konsideratë dënimet alternative apo ulja e dënimit për efekt të gjyqimit të shkurtuar por në të gjitha rastet do të duhet të vlerësohet DËNIMI KRYESOR që është ai prej 6 muaj burgim”, theksohet në kërkesën ankimore.

8. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dënime ndahen në DËNIME KRYESORE dhe në DËNIME PLOTËSUESE. Dënimet plotësuese, si rregull, shoqërojnë dënimin kryesor.

Dënimi i parashikuar nga neni 63 i K.Penal nuk është dënim plotësues. Ai është alternativë e dënimit kryesor, e cila vendoset nga gjykata në rrethana të caktuara. Në vendimin e GJKKO nr.11, datë 02.02.2023 që është dhënë ndaj shtetasit Qerim Ismailaj nuk janë aplikuar dënime plotësuese. Dënimi me 6 muaj burgim është dënim kryesor. Dënimi me 4 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, është dënim kryesor. Dënimi me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, në aplikim të nenit 63 të K.Penal, është dënim kryesor. Të tre dënimet e përmendura në dispozitivin e vendimit të GJKKO nr.11, datë 02.02.2023 janë dënime kryesore, të cilët janë aplikuar me zëvendësim, në rend zbritës. Pretendimi i ankuesit se dënim kryesor është vetëm “dënimi me 6 muaj burgim” është i pabazuar në fakt.

9. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, vendimi i GJKKO nr.11, datë 02.02.2023 e ka dënuar shtetasin Qerim Ismailaj me “detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh”. Ankuesi ka pretenduar se, në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për dekriminalizimin...” nuk mund të merret në konsideratë për identifikimin e masës së dënimit as ulja e dënimit, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, as pezullimi i ekzekutimit të tij, në aplikim të nenit 63 të K.Penal. Ky pretendim është i pambështetur në ligj. Referenca tek pika 9 e nenit 4 të ligjit nr.138/2015, “Për dekriminalizimin...” është e pasaktë dhe jo ligjore.

10. Neni 4 i ligjit nr.138/2015, “Për dekriminalizimin...” është dispozitë që zbatohet për përcaktimin e periudhës së ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar për personat që hyjnë në fushën e veprimit të nenit 2 të të njejtit ligji. Neni 4 nuk zbatohet për të futur persona të caktuar në fushën e veprimit të nenit 2. Personat e caktuar (në rastin e shkronjës “ç”) futen në fushën e veprimit të nenit 2, vetëm në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Dispozita e pikës 9 të nenit 4 diskonsideron “uljen e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistinë, depenalizimin, faljen, pezullimin e dënimit, lirimin e parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim të dënimit”, vetëm kur vjen puna për përlllogaritjen e periudhës së ndalimit.

11. Periudha e ndalimit ndryshon, në disa raste, në varësi të masës së dënimit të dhënë nga gjykata. Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të ligjit (dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim), ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë (pika 3 e nenit 4). Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2, të ligjit (dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim), ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal (pika 4 e nent 4). Dispozita e pikës 9 nuk lejon që të bëhet kapërcimi nga pika 3 në pikën 4 të nenit 4 duke “manovruar” në përlllogaritjen e masës së dënimit me “uljen e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistinë, depenalizimin, faljen, pezullimin e dënimit, lirimin e parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim të dënimit”.

12. Plotësimi i formularit të vetdeklarimit me gabime nuk mund të jetë shkak ligjor për mohimin e të drejtës për kandidim. Është detyrë e institucionit kompetent të bëjë analizën ligjore të fakteve të referuara dhe të bëjë klasifikimin e tyre sipas ligjit.

13. Në vlerësimin e KAS-it kandidati për kryetar bashkie në bashkinë Mallakastër, z.Qerim Ismailaj nuk ndodhet në kushtet e ndalimit të parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 2 të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë me “detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh”.

14. Pavarësisht nga ky fakt dhe përtej tij, edhe nga pozicioni i përfaqësuar nga ankuesi duhet pranuar si fakt i provuar në seancë me dëshmi penaliteti nga pala e interesuar, se kandidati për kryetar bashkie i bashkisë Mallakastër z. Qerim Ismailaj mban statusin “i padënuar”. Ky status mund të lëshohet për z. Qerim Ismailaj nga sistemi që administron bazën e të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale (e-albania) vetëm pas ekzekutimit të dënimit dhe rehabilitimit sipas kushteve të Kodit Penal. Administrimi i kësaj prove e detyron KAS-in që të njohë plotësimin e kushtit të rehabilitimit që kërkon pika 4 e nenit 4 të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Edhe nëse nisemi nga leximi që i bën ankuesi dispozitës së nenit 4, rehabilitimi shuan periudhën e ndalimit dhe rrëzon kërkesën ankimore”.

15. Partia Demokratike e Shqipërisë, më datë 21.04.2023, ka investuar Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, me padi me objekt:

- Shfuqizim i Vendimit Nr.60 Dt.19.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, “Për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.49, datë 17.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”;

- Shfuqizim i Vendimit Nr.366 Dt.15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për “Shqyrtimin e kërkesës së partisë demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”;

- Ndalimin e kandidimit të kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës, shtetasit Qerim Ismail Ismailaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

16. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pas konstatimit se Partia Socialiste e Shqipërisë kishte marrë pjesë në shqyrtimin administrativ të kësaj çështje në KQZ, disponoi vendimin e ndërmjetëm për thirrjen e saj në gjykim të në cilësinë e personit të interesuar, bazuar në Nenet 153 dhe 155 të Kodit Zgjedhor dhe në Nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë respektivisht se:

“Forma dhe përmbajtja e ankimit

1. Ankimi paraqitet në formën e kërkesëpadisë dhe duhet të përmbajë:

a) të dhënat për identitetin e paditësit;

b) tregimin e palës së paditur;

c) tregimin e palëve të interesuara. Palë të interesuara janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë KQZ-së;

ç) objektin e kërimit;

d) bazën ligjore;

dh) përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe pikat e vendimit të KQZ-së, të cilat ankuesi kundërshton; dhe

e) faktet, argumentet dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

2. Kërkesëpadia depozitohet në aq kopje sa është numri i palëve në proces, si dhe shoqërohet me kopjen e vendimit të KQZ-së dhe, sipas rastit, me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit. 3. Kërkesëpadia regjistrohët me paraqitjen e saj”. (Neni 153 i Kodit Zgjedhor)

“Procedura e shqyrtimit të kërkesëpadisë.

1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesëpadive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji Zgjedhor zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë.

2. Kolegji Zgjedhor gjykon me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Relatori i çështjes kryeson trupin gjykues”. (Neni 155 i Kodit Zgjedhor).

“Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

Sekretari njofton atë me letërthirrje”. (Neni 193 i K.Pr.Civile)

17. Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet kërkesëpadisë, ka pretenduar se:

- Nga dokumentacioni i depozituar në KZAZ përkatëse, e me pas i përcjelle pranë KQZ, rezulton se shtetasi Qerim Ismailaj, ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit formulari i dekriminalizimit në datën 27.03.2023. Nga përmbajtja e këtij formulari rezulton se në faqen 3, nën kategorinë "Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit", shtetasi në fjalë ka vetëdeklaruar, përveç një dënimi të marrë prej tij në vitin 2000 në shtetin grek, edhe një dënim të marrë në Shqipëri me këtë përmbajtje: "dënuar në Shqipëri; nr vendimi 11, datë 02.02.2023 GJKKO; masa e dënimit me burgim: 40 orë pune në aplikim të nenit 63 të Kodit penal"; neni: 190, aplikim i nenit 63; Lloji: falsifikim i formularëve".

- Pala paditëse ka bërë kërkesë pranë GJKKO, për t'u pajisur me kopje të vendimit të kësaj gjykate dhe i është vënë në dispozicion, kopje autentike e vendimit gjyqësor përkatës. Sipas përmbajtjes së vendimit rezulton se: Vendimi i GJKKO është dhënë nga gjykata nr.11 datë 02.02.2023, nr i aktit është 35/112 dhe data e regjistrimit në regjistrin themeltar të gjykatës është 05.10.2023.

Në dispozitivin e vendimit është vendosur:

- Deklarimi fajton të të pandehurit Qerim Ismailaj për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i nenit 190 të Kodit penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) muaj burgim.*
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Qerim Ismailaj me 4 (katër) muaj burgim.*
- Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 [dyzet] orësh, e cila do të përmbushet brenda afatit prej 6 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbaje kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës.*
- Kundër vendimit, lejohet ankimi nga palët, brenda 15 [pesë] ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke filluar ky afat nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit.*

- Në thembër, te kopjes autentike të aktit vendim gjyqësor, prej kryesekretarisë së GJKKO janë vendosur shënimet, nënshkrimet dhe vulosja përkatëse e cila dëshmon se ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë me datë 29.03.2023.

- Nga faktet e përshkruara më sipër, rezultojnë disa konkluzione të rëndësishme në funksion të analizës ligjore, rreth aplikimit korrekt të legjislacionit për dekriminalizimit e për pasojë edhe të analizës mbi lejimin/pengimin e kandidimit të shtetasit të mësipërm në zgjedhjet vendore të 14 majit.

- Në datë 06.04.2023 i janë drejtuar me shkresën me Nr.3421 Prot me anë të së cilës kanë kërkuar nga ana e KSHZ që të marrë masa dhe të ndalojë kandidimin e Z.Qerim Ismailaj pasi është në kushtet e ndalimit të përcaktuar në ligjin ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Në lidhje me legjitimimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë në vendimmarrjen e mëparshme me po të njëjtin subjekt dhe më konkretisht shtetasin Qerim Ismail Ismailaj, ky subjekt është legjitimuar si në vendimmarrjen e KSHZ dhe më konkretisht atë me Nr.422 datë 02.07.2021 dhe me anë të Vendimit të KAS me Nr.101 datë 07.07.2021. Gjithashtu në këtë vendimmarrje kërkuese është Partia Demokratike dhe vendimmarrja është marrë si pasojë e kërkesës së kësaj të fundit ndaj dhe ajo është e legjitimuar për t'u ankimuar ndaj vendimmarrjes së KSHZ.

- Pala paditëse pretendon se, formulari i vetdeklarimit, është plotësuar nga shtetasi Qerim Ismailaj në datë 27.03.2023, pra 2 [dy] ditë më parë, se vendimi i GJKKO të merrte formë të prerë. Ky konkluzion është i rëndësishëm për faktin se formulari përkatës kërkon që të deklarohen nën atë kategori vendimet gjyqësore të "formës së prerë" të dhëna nga autoritet shqiptare ose të huaja. Kujtojmë në këtë rast, edhe një fakt të rëndësishëm, siç është ai, sipas të cilit, data 27.03.2023 ka qenë data limit, për depozitimin e dokumentacionit për regjistrim si kandidat për zgjedhjet vendore. Tej kësaj date Kodi Zgjedhor nuk lejon aplikimin (depozitimin) e akteve të kandidimit. Procesi i vetdeklarimit i cili mishërohet në përmbajtjen e këtij formulari, kërkon që të deklarohet në mënyrë të vërtetë faktet, ngjarjet, rrethanat deri në atë date. Rezulton në këtë mënyrë, se shtetasi i mësipërm, nën kategorinë "vendime gjyqësore të formës së prerë të dhëna nga autoritete shqiptare apo të huaja" ka deklaruar një vendim gjyqësor i cili në atë datë, nuk e kishte marrë cilësimin juridik si "forme e prerë" (nga përmbajtja e shënimeve të kryesekretarisë gjyqësore, rezulton se vendimi ka marrë cilësimin si " të formës së prerë" në datë 29.03.2023). Pra rezulton se në datë 27.03.2023 është bërë një deklaram i pavërtetë rreth vendimit gjyqësor në fjalë.

- Së dyti, në formularin e vetedeklarimit, prej shtetasit të mësipërm, është shënuar, nën kategorinë "masa e dënimit me burgim" përshkrimi "40 ore pune në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal". Ky vetedeklarim rezulton qartazi jo i vërtetë krahasuar me atë çka është përmbajtja e dispozitivit të vendimit të gjykatës nr.11, datë 02.02.2023. Ky i fundit ka këtë përmbajtje: Deklarimi fajtor të të pandehurit Qerim Ismailaj për kryerjen e veprës penale "Fallsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i nenit 190 të Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Qerim Ismailaj me 4 (katër) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, e cila do të përmbushet brenda afatit prej 6 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbaje kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës. Qartësisht, vetedeklaruesi, nuk e ka përshkruar të saktë, dispozitivin e vendimit, sepse ka përpiluar një përshkrim të përmbledhur vetëm të pikës 3 të vendimit, por se ka ometuar të deklarojë 2 pika pararendëse të dispozitivit e konkretisht:

- Deklarimi fajton të të pandehurit Qerim Ismailaj për kryerjen e veprës penale "Fallsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i nenit 190 të Kodit penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Qerim Ismailaj me 4 (katër) muaj burgim.

- Në vetvete një përshkrim i tillë i dispozitivit të vendimit, përbën deklaram jo të saktë, të asaj çfarë vendimi i gjykatës përmban porse edhe te asaj çfarë formulari i vetdeklarimit kërkon. Kujtojmë, se nen këtë kategori, kërkohet deklarimi i "dënimit me burgim" dhe jo dënime të llojeve të tjera. Një përshkrim i rreme i përmbajtjes së vendimit, mund të ketë çuar KSHZ, në një situatë rreme, lidhur me thellësinë e verifikimit. Nëse do të ishte përpiluar në mënyrë korrekte, përmbajtja e dënimit, pra te ishte shënuar se bëhej fjalë për një dënim të natyrës "me burgim" edhe trajtimi ligjor dhe thellësia e verifikimeve e për pasojë edhe konkluzionet mbi lejim/ndalimin mund të ishin të ndryshme.

- Së treti, formulari i vetedeklarimit është nënshkruar personalisht nga shtetasi Qerim Ismailaj në çdo faqe të tij. Rezulton se shtetasi i mësipërm teksa ka plotësuar përmbajtjen e formularit, ka qenë në gjendje të kuptojë rëndësinë juridike të korrektësisë së vetedeklarimeve që përmban ky formular. Kjo del si rezultat jo vetëm i faktit, se shtetasi i mësipërm, përveçse zotëron aftësinë intelektuale për të kuptuar, përgjegjësinë juridike, të korrektësisë/moskorrektësisë së këtij akti dokumentar të rëndësishëm, por edhe për faktin se ai ka deklaruar se ushtron edhe profesionin e avokatit, pra që zotëron aftësi të specializuara në njohjen e ligjit.

- Kujtojmë se shtetasi i mësipërm, rezulton i dënuar, me vendim gjyqësor të formës së prerë për një veprë penale e cila objekt të saj ka patur pikërisht moskorrektësinë e përmbushjes së të njëjtit formular, këtë radhe në zgjedhjet vendore të vitit 2019. Për këtë shkak pra ai është proceduar, gjykuar dhe dënuar, e madje në vendimin e gjykatës në fjalë, gjykata ka arritur në konkluzionin se: "i pandehuri e ka kryer veprën penale në formën e dashjes direkte, forme e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Në këto kushte, gjykata vlerëson se shkalla e fajësisë së të pandehurit është e lartë". Kuptohet pra, se deklaruesi, në ndryshim nga pothuajse të gjithë kandidatet e tjerë, ka qenë në kushtet e pasjes së një vëmendje më të përqendruar në procesin e plotësimit të këtij vetdeklarimi.

- Nga analiza e fakteve të mësipërme, rezultojnë dy konkluzione të rëndësishme të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me vlerësimin që KSHZ duhet të bënte lidhur me vijueshmërinë e kandidimit ose jo te shtetasit Qerim Ismailaj në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

- Konkluzioni i pare: shtetasi i sipërcituar ka bërë një deklaram të rreme lidhur me fakte, akte, ngjarje, të cilat kanë pasojë të drejtpërdrejt në konkluzionin ligjor që KSHZ duhet të merrte. Ka deklaruar si të "formës së prerë" një vendim i cili nuk e kishte këtë cilësi, dhe se dyti ka ometuar te deklaroje se vendimi i gjykatës e ka deklaruar fajtor dhe e ka dënuar "me burgim" në masën "6 muaj".

- Të dy këto elemente plotësojnë katërcipërisht, se nëpërmjet procesit të përpilimit të formularit të vetdeklarimit, shtetasi i mësipërm ka konsumuar (përsëri) veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Fallsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve". Kjo është një situatë ligjore, sipas së cilës, detyron këdo, që vihet në dijeni të këtij fakti, e me së pari autoritetin shtetëror të ngarkuar nga ligji, të bëjë verifikimet përkatëse (në këtë rast KSHZ), që të ezurojë menjëherë, paraqitjen e kallëzimit penal pranë prokurorisë përkatëse.

- Pala paditëse pretendon se në dijeninë e tyre të deritanishme një fakt i tillë nuk ka ndodhur, kjo ndoshta për faktin, se shtetasi i sipërcituar, ia ka fshehur këtij autoriteti të dhënat e plota. Tashmë që ata kanë vendosur të dhëna dhe shpjegime të plota, rreth situatës, lind detyrimi ligjor ndaj KSHZ, por jo vetëm, të përmbushë edhe këtë detyrim që buron nga Kodi i Procedurës Penale (nenet 280 e vijues te tij).

- Konkluzioni i dytë: shtetasi Qerim Ismailaj, i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, pranë KZAZ nr.62 Mallakastër, duhet të ndalohet të kandidojë, për shkakun se sipas parashikimeve të ligjit 138/2015 "Për dekriminalizimin..." rezulton se bie brenda sferës së aplikimit të këtij ligji.

- Ligji 138/2015 parashikon nenin 2 pika ç) se: Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

- Në rastin konkret, del e qartë se shtetasi Qerim Ismailaj, është dënuar me 6 muaj burgim, dhe se ky dënim është i formës së prerë. (Është pikërisht ky parashikim i vendimit që nuk është deklaruar në formularin përkatës). Dispozita ligjore pra kërkon qartazi që nga gjykata të jetë shqiptuar si mase dënimi pikërisht (dënimi me burgim me jo më pak se 6 muaj burgim). Ky konstruksion logjiko-ligjor, kërkon së pari masën e dënimit e cila duhet të jetë jo më pak se 6 muaj dhe llojin e dënimit që duhet të jetë "burgim". Lidhur me masën e dënimit, siç sintaksa e dispozitës përshkruhet kërkohet që masa numerike e dënimit të jetë "jo me pak se 6 muaj" pra që përfshin dënimin 6 muaj apo më shumë se kjo mase dhe përjashton masën numerike me pak se 6 muaj (pra 5 muaj e 29/30 dite sipas rastit). Në rastin e vendimit në fjalë gjykata ka shqiptuar masën numerike 6 muaj, pra kjo është hipoteze që përfshihet në parashikimin e nenit 2 pika "ç".

- Përsa i përket llojit të dënimit, gjykata ka shqiptuar pikërisht dënimi "me burgim", dhe kjo është një çështje jashtë çdo dyshimi apo mundësie interpretimi.

- Është i vërtetë fakti se vendimi i gjykatës në pikat 2 dhe 3 ka shqiptuar një reduktim të masës së dënimit (për shkak të aplikimit të nenit 406 te KPP- gjykimi i shkurtuar dhe konvertimin në "pune në interes publik"). Në pamje të parë duket se këto reduktime apo konvertime të masës së dënimit "shmangin" aplikimin e nenit 2 pika "ç", pra konkretisht të frazës së përdorur "kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim". Mesa kuptohet ky ka qenë edhe qëllimi i vetdeklaruesit teksa ka shënuar në formular vetëm "dënimin me 40 orë pune në interes publik". Ky hamendesim është jo i vërtetë. Ligji 138/2015 ka parashikuar edhe hipotezën kur, gjykata shqipton si vendim kryesor dënimin me burgim por se për shkak të parashikimeve ligjore, masa dhe lloji i dënimit reduktohet apo konvertohet në një tjetër dënim.

- Konkretisht në nenin 4 pika 9 të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" parashikohet se: Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimit të periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

- Në rastin konkret, rezulton se dënimi thelbësor (6 muaj burgim), ka pësuar një "ulje dënimi për shkak të gjykimit të shkurtuar (pika 2 e vendimit) dhe një pezullim (pika 3 e vendimit). Të dyja këto hipoteza janë të parashikuara nga neni 4 pika 9, e për pasojë nuk i sjellin kurrfarë efekti, ndaj parashikimit të nenit 2 pika "ç".

- Për pasojë në asnjë mënyrë nuk mund të merret në konsideratë dënimet alternative apo ulja e dënimit për efekt të gjykimit të shkurtuar por në të gjitha rastet do të duhet të vlerësohet dënimi kryesor që është ai prej 6 muaj burgim.

- Si çështje e fundit që meriton sqarim është edhe ajo e periudhës së ndalimit sipas nenit 4 pika 4 e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose

ushtrojnë funksione publike". Në këtë dispozite parashikohet se periudha e ndalimit për këta shtetas do të jete ajo çka parashikohet në neni 69 të Kodit Penal dhe më konkretisht: Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

- Më konkretisht në nenin 69 të Kodit Penal referohet se:

Quhen të padënuar:

a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

- Përfundimisht në bazë të parashikimeve ligjore të mësipërme rezulton që situata juridike e shtetasit Qerim Ismail Ismailaj bie në kushtet e ndalimit të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe më konkretisht të neneve 2 dhe 4 të tij sepse, rezulton se me Vendimin Nr.11 datë 02.02.2023 të GJKKO i pandehuri Qerim Ismailaj është dënuar me vendim të formës së prerë me 6 muaj burgim sipas pikës 1 të këtij vendimi për veprën penale "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i Kodit Penal. Siç shihet dhe nga vendimi i gjykatës kjo vepër kryhet vetëm me dashje dhe në këto kushte ky shtetas ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar.

Vendimi gjyqësor është dhënë nga një autoritet shqiptar

Vendimi është i formës së prerë.

Periudha e rehabilitimi prej 2 vjetësh nuk është ezauruar.

- KSHZ në vendimmarrjen e tij me Nr.366 date 15.04.2023 jep arsyet e vendimmarrjes dhe arsyeton vendimmarrjen e tij duke dhënë argumentet si më poshtë dhe më konkretisht: "Në vlerësim të dokumentacionit të mësipërm, si dhe bazuar në nenin 63 paragrafi i gjashtë i Kodit Penal çmohet se kandidati për Kryetar Bashkie z. Qerim Ismailaj nuk është në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur dhe emëruar në funksione publike sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015. Urdhërimi i paragrafit të parafundit të nenit 63 të Kodit Penal, që pas kryerjes së punës në interes publik, dënimi konsiderohet i paqenë, i adresohet çdo autoriteti shtetëror për sa duhet të ndikohet në marrëdhënien e ardhshme ligjore me shtetasin e dënuar. Urdhërimi i Kodit Penal për të mos konsideruar, dënimet penale në rast alternimi me orë pune, mbetet prioritar ndaj çdo ligji që nuk ka fuqinë e vetë Kodit. I vetmi kontroll paraprak që mbetet për të realizuar, përpara detyrimit moskonsiderues, është këqyrja e vetë vendimit, kryerjes së orëve të punës, kohës së realizimit e verbal ekzekutimit. Çdo korrektesë në përmbajtjen e kohës së ekzekutimit, e dëshmuar me vërtetim te autoritetit përkatës, veçanërisht prokurorit kompetent për ekzekutimin, shuan cdo pengesë ligjore passjellëse të vetë dënimit fillestar (i konsideruar i pa qenë si dënim, pra nuk ekziston). Ndaj kërkesa e subjektit zgjedhor Partia Demokratike për të ndaluar kandidimin e z. Qerim Ismailaj, si kandidat për kryetar të Bashkisë Mallakastër, nuk është e bazuar në ligj dhe duhet të rrëzohet."

- Me siguri KSHZ do t'i ketë interpretuar gabim hierarkinë e normave dhe kush nga këto dispozita do të merret në konsideratë në arsyetimin ligjor Kodi Penal i RSH i cili për miratimin e tij do të duhet të votojnë së paku 3/5 e Deputetëve të Parlamentit të RSH dhe të Ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i cili gjithashtu për tu miratuar kërkon të votojnë së paku 3/5 e Deputetëve të Parlamentit të RSH por besoj që ajo që e ka konfunduar KSHZ ka qenë fakti që i pari quhet KOD ndërsa ky i fundit vetëm LIGJ.

- KSHZ me siguri harron që dispozita e parashikuar në nenin 63 është ndryshuar për herë të fundit vetëm në vitin 2008 me anë të ligjit Nr.10023 datë 27.11.2008 ndërsa ligji nr.138/2015,

"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" është miratuar në vitin 2015 pra 7 vite më vonë.

- KSHZ me siguri ka menduar që legjislatori nuk ka qenë në dijeni të dispozitës së përcaktuar në nenin 63 të Kodit Penal kur ka vlerësuar gjithsesi që në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" përsëri te vendos në nenin 4 pika 9 të tij se: " 9. Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit."

- Ky arsytim i KSHZ jo vetëm që është i pabazuar po është dhe allogjik pasi nuk ka asnjë mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit por as në të gjithë praktikën gjyqësore dhe ligjore të krijuar që nga e Drejta Romake e deri në ditët e sotme. Qe në fillimet e studimeve të larta në drejtësi studentët përballen me një nga parimet kryesore të të Drejtës Romake që është "Lex specialis derogat legi generali". Ky parim është i zbatueshëm dhe sot në praktikën gjyqësore dhe ligjore në të gjitha vendet që aplikojnë sistemin ligjor të njohur si Civil Laë.

- Legjislatori në hartimin e këtij ligji special dhe më konkretisht atij me Nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i kanë pasur fare të qarta dispozitat e Kodit Penal dhe më konkretisht dhe të atyre të përcaktuara në nenin 63 të tij ndaj me mençuri ka vendosur dhe pikën 9 në nenin 4 duke arsyetuar që të gjitha llojet e pezullimit të dënimit të dhëna nga gjykata nuk do të duhet të konsiderohen dhe se për efekt të zbatimit të ligjit do të merret vetëm masa e dënimit.

- Po çfarë referon në titull neni 63 i Kodit Penal "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik" dhe më konkretisht dhe dispozita ligjore e përcaktuar në nenin 4 pika 9 i referohet dhe dispozitës të nenit 63 dhe ndaj legjislatori ka qenë i vëmendshëm për ta përcaktuar këtë dënim si rast që nuk mund të merret në konsideratë për shmangien nga zbatimi i këtij ligji pavarësisht bindjes së KSHZ që legjislatori është treguar jo vigjilent.

- Gjithashtu KSHZ ka ndërmarrë dhe hapa të tjerë duke marrë dhe rolin e Prokurorit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale duke analizuar dhe faktin se kur do të duhet të fillojë ekzekutimi dhe a është ekzekutuar ky vendim nga ana e të pandehurit. Megjithëse është lodhur shumë në arsytim përsëri ai ka harruar faktin që vendimi ka marrë formë të prerë vetëm në datën 29.03.2023 2 ditë para se të kandidonte shtetasi Qerim Ismail Ismailaj si kandidat për Bashkinë Mallakastër.

- Pas shqyrtimit nga ana e KAS ky i fundit nuk i qëndrojë arsytimit të KSHZ por bëri një interpretim tjetër në lidhje me dispozitën duke dhënë arsye të tjera të cilat në intepretim tonë të dispozitës përsëri mbetën të gabuara dhe nuk i përputhen synimit të legjislatorit në hartimin e këtij ligji.

- Në arsytimin e tij KAS argumenton se: "Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dënime ndahen në dënime kryesore dhe në dënime plotësuese. Dënimet plotësuese, si rregull, shoqërojnë dënimin kryesor. Dënimi i parashikuar nga neni 63 i K.Penal nuk është dënim plotësues. Ai është alternativë e dënimit kryesor, e cila vendoset nga gjykata në rrethana të caktuara. Në vendimin e GJKKO nr. 11, datë 02.02.2023 që është dhënë ndaj shtetasis Qerim Ismailaj nuk janë aplikuar dënime plotësuese. Dënimi me 6 muaj burgim është dënim kryesor.

Dënimi me 4 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, është dënim kryesor. Dënimi me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, në aplikim të nenit 63 të K.Penal, është dënim kryesor. Të tre dënimet e përmendura në dispozitivin e vendimit të GJKKO nr.11, datë 02.02.2023 janë dënime kryesore, të cilët janë aplikuar me zëvendësim, në rend zbritës. Pretendimi i ankuesit se dënim kryesor është vetëm "dënimi me 6 muaj burgim" është i pabazuar në fakt".

- Në asnjë moment nga ana jonë nuk është referuar fakti që aplikimi i nenit 406 i Kodit të Procedurës Penale si dhe neni 63 i Kodit Penal janë dënime plotësuese por kemi referuar të kundertën duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 pika 9 e ligjit Nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i cili është fare i qartë që për efekt të zbatimit të këtij ligji nuk mund të merren në konsideratë dënimet alternative.

- Konkluzioni tjetër i KAS për rrëzimin e këtij ankimi ka të bëjë me faktin që këtë subjekt e cilëson të rehabilituar dhe nuk është në kushtet e ndalimit sipas parashikimeve të nenit 4 pika 4 të ligjit Nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Ndër të tjera KAS arsyeton se: Pavarësisht nga ky fakt dhe përtej tij, edhe nga pozicioni i përfaqësuar nga ankuesi duhet pranuar si fakt i provuar në seancë me dëshmi penaliteti nga pala e interesuar, se kandidati për kryetar bashkie i bashkisë Mallakastër z. Qerim Ismailaj mban statusin "i padënuar". Ky status mund të lëshohet për z. Qerim Ismailaj nga sistemi që administron bazën e të dhënave për ekzekutimin e vendimeve penale (e-albania) vetëm pas ekzekutimit të dënimit dhe rehabilitimit sipas kushteve të Kodit Penal. Administrimi i kësaj prove e detyron KAS in që të njohë plotësimin e kushtit të rehabilitimit që kërkon pika 4 e nenit 4 të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Edhe nëse nisemi nga leximi që i bën ankuesi dispozitës së nenit 4, rehabilitimi shuan periudhën e ndalimit dhe rrëzon kërkesën ankimore."

- Ky arsyetim nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe bie ndesh totalisht me atë çka ai i kërkon organit publik për zbatimin e tij.

- Së pari vlen për t'u cituar neni 45 pika 3 e Kushtetutës që parashikon se "3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike". Më tej, si bazë ligjore do i referohemi edhe ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" i ndryshuar, vendimit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"" të Kuvendit të Shqipërisë dhe K.Penal.

- Këtu vlen për t'u theksuar se sa i përket këtyre normave, ligji nr.138/2015 ka përparësi mbi K.Penal në kuptim të zgjedhshmërisë. Jurisprudenca kushtetuese i ka dhënë zgjidhje konfliktit që krijohet mes normave ligjore, duke pranuar përparësinë që kanë ligjet e posaçme ndaj ligjeve të përgjithshme (lex specialis derogat legi generali), si dhe ligjet që kanë hyrë në fuqi më vonë, krahasuar me ligjet e mëparshme (Shih vendimin nr.2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

- Më konkretisht në nenin 1 pika 1 të ligjit nr.138/2016, nder të tjera parashikohet se "Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, ..., nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ... të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të

cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji", çka e bën të qartë statusin e këtij ligji si ligj i posaçëm në raport me normat e tjera, përfshirë këtu edhe K.Penal.

- Sa i përket parimit lex superior derogat inferiori, këtu duhet theksuar se si ligji nr.138/2015 ashtu dhe K.Penal janë miratuar me shumicë të cilësuar, ndaj qëndrojnë në të njëjtin nivel sa i përket hierarkisë së normave juridike. Ndërkohë në lidhje me hyrjen në fuqi, ligji nr.138/2015 ka hyrë në fuqi më vonë në kohë në raport me K.Penal çka e bën që të ketë përparësi mbi këtë të fundit në raport me ato çështje që mund të ketë konflikt mes dy normave. Gjithashtu, konfliktin midis normave e ka rregulluar edhe vetë ligji nr.138/2015 ku në nenin 16 pika 4 të tij ka parashikuar se "4. Dispozitat e këtij ligji janë të barasvlershme me dispozitat e Kodit Zgjedhor, ligjit për nëpunësin civil dhe ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përfshihen nga veprimi i këtij ligji. Në rast konflikti midis normave, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi".

- Shtetasi Qerim Ismail Ismailaj, në zbatim të nenit 2 pika 1 shkronja "ç" të ligjit nr.138/2015 është në kushtet e ndalimit për të kandiduar duke qenë se Vendimi nr.11, datë 2.2.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar është i formës së prerë dhe e ka dënuar atë me dënim kryesor 6 muaj burgim. Më konkretisht, neni 2 pika 1 shkronja "ç" e ligjit nr. 138/2015 parashikon se "1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: ... ç) kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim Po ashtu neni 4 pika 9 e po të njëjtit ligj parashikon se "9. Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit".

- Duke analizuar vendimin nr.11, datë 2.2.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar që ka vendosur: "1. Deklarimin fajtor të z.Qerim Ismailaj, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimi i vulave, i stampave ose formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i K.Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim; 2. Në aplikim te nenit 406 të K.P.Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim; 3. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të pandehurit z.Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh", arrihet në përfundimin se në kuptim të nenit 29 të K.Penal, duke qenë se neni 190 i po këtij kodi e parashikon si krim veprën penale për të cilën është dënuar shtetasi Qerim Ismailaj, atëherë dënimi kryesor i dhënë për të është ai "me burgim".

- Po ashtu, siç rezulton dhe nga dispozitivi i vendimit, ulja e dënimit kryesor me burgim, nga 6 muaj në 4 muaj, është bërë për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar që në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, passjell uljen e dënimit me 1/3 e tij. Ndërkohë, në pikën 3 të dispozitivit që parashikon se "Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim te pandehurit z.Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik...", vihet re

që në zbatim të kreut VII të Pjesës së Përgjithshme të K.Penal, ndaj shtetasit Qerim Ismailaj, është pezulluar dënimi kryesor me burgim dhe i është caktuar një mënyrë alternative e dënimit sipas nenit 63 të K.Penal.

- Më konkretisht, ky nen, në paragrafin e tij të parë parashikon se "Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së paketë të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik". Po ashtu, duhet theksuar se nga doktrina, por po ashtu edhe nga vetë vendimi i gjykatës del qartë që vepra penale e parashikuar nga neni 190 e K.Penal, sa i përket anës subjektive në kryerjen e saj, kryhet vetëm me dashje, ndaj plotësohen të gjithë elementet e parashikuar nga neni 2 pika 1 shkronja "ç" e ligjit nr. 138/2015.

- Nga analiza si më sipër e dispozitivit del qartë që dënimi kryesor i vendosur nga GJKKO është ai i burgimit me 6 muaj në dëm të shtetasit Qerim Ismailaj. Ndërkohë elementët e tjerë të vendimit, si ulja e dënimit dhe më tej caktimi i një dënimi alternativ, janë pasojë e aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim. Të dy këto elementë, në raport me të drejtën kushtetuese të shtetasit Qerim Ismailaj për t'u zgjedhur, në zbatim të nenit 4 pika 9 të ligjit nr.138/2015, nuk ndikojnë në raport me periudhën e ndalimit sipas ligjit nr.138/2015 për aq kohë sa vetë ligji, në mënyrë eksplicite i ka përjashtuar si elementë në raport me të drejtën për t'u zgjedhur.

- Në lidhje me periudhën e ndalimit të kandidimit për shtetasin Qerim Ismailaj, ajo parashikohet nga neni 4 pika 4 e ligjit nr.138/2015 që më konkretisht parashikon se "4. Për personat e dënuar për kryerjen e një krimi që parashikohet nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal".

Neni 69 shkronja "a" e K.Penal parashikon se "Quhen të padënuar: a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer veprë tjetër penale". Në këto kushte, për efekt të dekriminalizimit, përudha e ndalimit të kandidimit për shtetasin Qerim Ismailaj zgjat 2 vjet, afat ky që fillon të ecë nga momenti që ai ka kryer punën në interes publik.

- Sipas shkresës me nr.1128/6 Prot/Q.Sh., datë 10.03.2023 me lëndë "Dërgohet vendimi i prokurorit për përfundimin e dënimit alternativ" rezulton se "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës Dega Territoriale Fier me shkresën Nr. 195/2 Prot, datë 03.03.2023, i është dërguar një kopje të raportit të vlerësimit për të pandehurin Qerim Ismailaj, ku sipas këtij raporti më datë 28.02.2023, e ka përfunduar plotësisht dënimin e dhënë nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë".

Nisur nga sa më sipër, përudha e ndalimit për të kandiduar për shtetasin Qerim Ismailaj përfundon në datë 02.03.2025.

- Për sa më sipër Kolegji Gjyqësor Zgjedhor do të duhet të shfuqizojë Vendimin Nr.60 datë 19.04.2023 të KAS dhe Vendimin Nr.366 datë 15.04.2023 të KSHZ dhe të konstatojë pengesën ligjore të shtetasit Qerim Ismail Ismailaj për të marrë pjesë në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 dhe të vendosi ndalimin e kandidimit të subjektit Qerim Ismail Ismailaj për të kandiduar si Kryetar i Bashkisë Mallakastër, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë".

18. I padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prapësoi se:

“- Referuar pretendimit të parë të paditësit se KAS është organi kompetent për shqyrtimin e procesit të plotësisht të formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë

Mallakastër z.Qerim Ismail Ismailaj, pasi sipas paditësit ai ka konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Fallsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” nuk qëndron, kjo sepse është jashtë kompetencës së KAS-it. Ankimi i bërë ka përmbajtje dhe natyrë penale, dhe si e tillë duhet shqyrtuar në rrugë gjyqësore. Nëse paditësi e ka konstatuar këtë fakt të z.Ismailaj, ai do të duhej të ndiqte rrugën ligjore pranë prokurorisë përkatëse, me anë të një kallëzimi penal. KAS çmon se nuk mund të marrë këtë çështje me objekt shqyrtimi vepër penale.

- Gjithashtu, shqyrtimi i kësaj ankese nga KAS, lidhet me faktin se paditësi ka qenë ai që ka vënë në lëvizje Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, me anë të kërkesës së tij dhe rrjedhimisht vendimet e Komisionerit gjejnë hapësirë ankimimi në KAS.

- Referuar pretendimit të dytë të paditësit, ku shprehet se kandidati për kryetar bashkie Mallakastër për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 ka shënuar në formularin e vetëdeklarimit nën kategorinë mbi masën e dënimit “40 orë pune në aplikim të Kodit Penal”, duke mos e shprehur saktë krahasuar me dispozitivin e vendimit të GJKKO nr. 11, datë 02.02.2023, sqaron se:

- Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dënimi i parashikuar nga neni 63 i K.Penal nuk është dënim plotësues, por është alternativë e dënimit kryesor, e cila vendoset nga gjykata për shkak të rrezikshmërisë së paktët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, për dënime gjer në një vit burgim. Në vendimin e GJKKO nr. 11, datë 02.02.2023 që është dhënë ndaj z.Qerim Ismailaj nuk janë aplikuar dënime plotësuese. KAS- i konstaton se dënimi me 6 muaj burgim, dënimi me 4 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, si dhe dënimi me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, në aplikim të nenit 63 të K.Penal, janë dënime kryesore. Të tre dënimet e cituara në dispozitivin e vendimit të GJKKO nr. 11, datë 02.02.2023 si dënime kryesore, janë aplikuar me zëvendësim, në rend zbritës. Pretendimi i paditësit se dënim kryesor është vetëm “dënimi me 6 muaj burgim” është i pabazuar në fakt.

- Z. Qerim Ismailaj është dënuar nga GJKKO, sipas nenit 63 të Kodit Penal me “detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh”. Pretendimi i paditësit se: “në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për dekriminalizimin...” nuk mund të merret në konsideratë për identifikimin e masës së dënimit as ulja e dënimit, në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, as pezullimi i ekzekutimit të tij, në aplikim të nenit 63 të K.Penal” nuk gjen mbështetje në ligj, pasi dënimi final mbetet ai i detyrimit për kryerjen e një pune në interes publik brenda periudhës 6 mujore. Referenca e paditësit tek pika 9 e nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, “Për dekriminalizimin...” është jo ligjore.

- Lidhur me pretendimin tjetër të paditësit mbi çështjen e periudhës së ndalimit sipas nenit 4, pika 4 të ligjit nr.138/2015, KAS është shprehur se periudha e ndalimit ndryshon në varësi të masës së dënimit të dhënë nga gjykata. Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të ligjit (dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim), ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë (pika 3 e nenit 4). Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2, të ligjit (dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim), ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal (pika 4 e nent 4). Dispozita e pikës 9 nuk lejon që të bëhet kapërcimi nga pika 3 në pikën 4 të nenit 4, duke përllogaritur ndryshe masën e dënimit me “uljen e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistinë, depenalizimin, faljen, pezullimin e dënimit, lirimimin e parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim të dënimit”.

- Në konkluzion, z.Qerim Ismail Ismailaj, kandidati për kryetar bashkie në bashkinë Mallakastër mban statusin “i padënuar”, provuar kjo në seancën e KAS-it dhe nuk ndodhet në

kushtet e ndalimit të parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 2 të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi është dënuar me vendim të formës së prerë me “detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh”.

- Për sa më sipër, pala e paditur kërkon rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi, “Partia Demokratike e Shqipërisë”, lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 19.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 49, datë 17.04.2023, depozituar nga ‘Partia Demokratike e Shqipërisë’”, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”.

19. Personi i tretë Partia Socialiste e Shqipërisë, prapësoi se:

“- Kandidati i propozuar nga Partia Socialiste për kryetar në Bashkinë Mallakastër, z. Qerim Isamilaj plotëson kriteret për kandidim dhe nuk kishte ndalim sipas ligjit. Në këto kushte ky subjekt është përfshirë në listën e candidateve të Partisë Socialiste, për shkak se: z. Qerim Ismailaj e ka shlyer dënimin e dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar, e për këtë arsye nuk është në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur dhe emëruar në funksione publike.

- Sipas vendimit datë 9.3.2023 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila ka vendosur: “ 1. Të konsiderojë të kryer dënimin alternativ të dhënë me vendimin penal nr. 35/112 akti, datë 2.2.2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar për të pandehurin Qerim Ismailaj; 2. Me përfundimin e punës nga i pandehuri Qerim Ismailaj, dënimi konsiderohet i paqenë .”

- Sipas vërtetimit me nr.195/3 datë 9.3.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dega Territoriale Fier, në të cilin specifikohet se z. Qerim Ismail Ismailaj ka kryer periudhën e dënimin alternativ prej 40 (dyzetë) orë pane në interes publik të vendosur me vendimin nr. 31/112, akti datë 2.2.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar.

- Është e rëndësishme të evidentohet mungesa e legjitimitetit të subjektit zgjedhor PDSH për paraqitjen e këtij ankimi. Pika e tretë e objektit të padisë është e formuluar sic vijon "Ndalimin e kandidimit të Kandidatit për kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë." Pra, padia në thelb kërkon që të ndalohet kandidimi i subjektit zgjedhor për Bashkinë Mallakastër Z. Qerim Ismailaj. Kjo nuk mund të jete e ligjshme si kërkesë pasi subjekti është tashmë i regjistruar me vendimin nr.04 date 28.03.2023 te KZAZ nr.62 dhe ndërkohë kërkesa e paditësit de facto kërkon ç' regjistrimin e këtij subjekti dhe pjesëmarrjen e një subjekti tjetër. Shfaqja e interesit për të çregjistruar një subjekt tjetër zgjedhor është një praktikë e ndaluar tashmë jo vetëm nga vendimmarrja e KAS, ref vendimit Nr.40 datë 03.04.2023, por dhe nga praktika e vete Kolegjit Zgjedhor, i cili në vendimin Nr.1 date 09.05.2019 ka pranuar se: "Fakti qe nje subjekt zgjedhor regjistrohet neëzgjedhje dëshmon se interesat e tij te ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për çregjistrim e një tjetër subjekti zgjedhore nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor ”.

- Praktika e paraqitur nga Partia Demokratike sipas vendimit Nr.101 date 07.07.2021, në lidhje me legjitimitimin e saj është një praktike qe provon te kundërtën e interesit te ligjshëm, pasi në atë kohë procedura ishte e vënë në lëvizje nga vete subjekti Partia Demokratike, fakt që e pranoj dhe vete paditësi në seance me paraqitjen e një kërkesë në prokurori me objekt verifikimin e pastërtisë së figurës së subjektit Qerim Ismailaj. Në rastin objekt gjykimi kemi të bëjmë me një procedure ex officio të vete organit sa i takon vendimit Nr.300 datë 05.04.2023. Në këto kushte

vlerësojmë se ndodhemi në kushtet e mospranimit të ankesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë për mungesë legjitimiteti dhe interesi të ligjshëm.

- Sipas paditësit, përfshirja në konkurim e subjekteve që sipas ligjit nuk mund të marrin pjesë në zgjedhje, çënon ligjshmërinë e zgjedhjeve dhe kushtet e barabarta midis subjekteve zgjedhore. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor duhet së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv.

- Lidhur me legjitimitetin aktiv që padia të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi dhe b) legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, për të pranuar apo rrëzuar atë. Në lidhje me interesin e ligjshëm për të ngritur padi, interesi për të ngritur padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi, është një interes procedural dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është çënuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Interesi për të ngritur padi i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të çënuar.

- Në nenin 145 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: "Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në kolegjin zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të K.Q.Z-së kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshme brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, ”

- Në rastin në shqyrtim shtohet pyetja cili është interesi i ligjshëm i paditësit dhe a i është çënuar interesi i ligjshëm, çfarë cenimi i është shkaktuar palës paditëse?

- Në momentin e regjistrimit pranë K.Q.Z. çdo subjekt zgjedhor, kryen këtë veprimtari me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cili subjekt do të marri pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre në këto zgjedhje. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm nëse nga K.Q.Z, ky subjekt do të regjistrohej apo jo, pas kërkesës që ai do t'i bënte K.Q.Z-së.

- Paditësi si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga K.Q.Z, si i tillë për rrjedhojë nuk i është çënuar asnjë interes i tij. Regjistrimi nga K.Q.Z i çdo subjekti apo mosregjistrimi i tij nuk çënon interesat e subjekteve të tjerë të cilëve u është pranuar ose jo regjistrimi si subjekt zgjedhor. Subjekti zgjedhor përfshi dhe partitë politike, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet që do të regjistrohen nga K.Q.Z. Fakti që një subjekt zgjedhor regjistrohet në zgjedhje dëshmon se interesat e tij të ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për çregjistrimin e një tjetër subjekti zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interesa të ligjshme të subjektit zgjedhor, si kusht për ngritjen e kësaj padie në bazë të nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

- Kërkesa për çregjistrimin nga paditësi është kërkesë që nuk përmbush interesa të ligjshme të asnjë subjekti përfshirë dhe vetë Partinë Demokratike të Shqipërisë, për shkak se kjo kërkesë çënon një nga kriteret kryesorë atë të konkurueshmërisë së procesit zgjedhor. Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo subjekti zgjedhor nuk çënon interesat e ligjshme të paditësit. Në vlerësimin tone pala paditëse nuk gëzon legjitimitetin aktiv pasi nuk çënohen interesat e tij të ligjshme siç mund të jenë edhe kushtet e zhvillimit të zgjedhjeve.

- Kodi Zgjedhor në nenin 124 parashikon jo vetëm subjektet që legjitimohen të paraqesin ankim administrativ, por ka përcaktuar edhe faktin se legjitimimi i këtyre subjekteve është i lidhur me cënimin e interesave të tyre të ligjshëm. Pala ankuese nuk ka treguar në ankimin e paraqitur ku është cënuar në interesin e saj, interes i cili duhet të jetë i mbrojtur nga ligji dhe të jetë cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga akti i ankimuar, kërkesë kjo e domosdoshme e parashikuar nga neni 124 i Kodit Zgjedhor.

- Ligji nr.138/2015, në nenin 7 të tij, ka përcaktuar në mënyrë të shprehur subjektet që kanë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave. Partitë politike vetëm në një rast janë legjitimuar të kërkojnë verifikimin paraprak për kandidatura në zgjedhje dhe kjo vetëm për kandidatët e mundshëm të saj, jo për kandidatët e subjekteve të tjera zgjedhore, përcaktim ky i parashikuar në pikën 5 të dispozitës në fjalë. Përsa kohë që në një rast të tillë subjekti zgjedhor nuk legjitimohet të kërkojë verifikimin paraprak të kandidatit, nuk mund të legjitimohet edhe për të ankimuar vendimin e KSHZ që ka disponuar lidhur me rezultatet e verifikimeve paraprake. Mjafton ky shkak që Kolegji të disponojë rrëzimin e padisë për shkak të moslegjitimitit të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë në paraqitjen e ankimit.

- Më tej, pretendimet e parashtruara në ankim rezultojnë të jenë plotësisht të pabazuara në parashikimet e ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Pala ankuese pretendon se kandidati Qerim Ismailaj ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në datën 27.03.2023, duke pasqyruar në formular vendimin nr.11 datë 02.02.2023 të GJKKO si vendim të formës së prerë, ndërkohë që vendimi ka marrë formë të prerë në datën 29.03.2023. Plotësimi i këtij formulari është bërë nga kandidati në kushtet kur komunikimi i vendimit të arsyetuar atij i është bërë në datën 10.03.2023 dhe në kushtet kur ai nuk ka ankimuar vendimin dhe Gjykata ka disponuar sipas kërkesës së prokurorit, ndaj nuk kishte shkak për ankim, ka vlerësuar se vendimi do të kishte marrë formë të prerë në datën 27.03.2023. Por, një fakt i tillë, kur vetëm dy ditë më pas, vendimi ka marrë formë të prerë dhe aktualisht është i formës së prerë, nuk e bën formularin e vetëdeklarimit të plotësuar me të dhëna të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta, në kushtet kur formulari përmban gjithë të dhënat e detyrueshme të parashikuara në Kreun III pika l të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit. Këto të dhëna janë deklaruar në mënyrë të plotë e të saktë përsa përmbushin qëllimin e vetëdeklarimit, pasi Kandidati ka deklaruar atë që është thelbësor, dënimin e dhënë ndaj tij. Aktualisht vendimi është i formës së prerë dhe fakti që në vendim përcaktohet si datë e marrjes formë të prerë të vendimit, data 29.03.2023, pra vetëm dy ditë pas deklarimit, nuk e bën deklarimin të pavërtetë.

- I pabazuar është pretendimi i parashtruar në padi edhe lidhur me faktin se kandidati në rubrikën "masa e dënimit me burgim" ka plotësuar "40 orë pune në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal. Në të kundërt nga sa arsyeton pala ankuese, vetëdeklarimi në këtë moment është në përputhje të plotë me sa ka disponuar gjykata me vendimin nr. 11 datë 02.02.2023 por edhe me parashikimet e nenit 63 të Kodit Penal që referon se dënimi me burgim, në kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë, zëvendësohet me detyrimin e të dënuarit për të përmbushur një punë në interes publik. Edhe në rastin e kandidatit Qerim Ismailaj, Gjykata pikërisht duke aplikuar kriteret e nenit 63 të Kodit Penal ka aplikuar pikërisht detyrimin e tij për të kryer punë në interes publik, pa pagesë, për 40 orë, detyrim ky që sikurse parashikon vetë dispozita në fjalë zëvendëson dënimin me burgim. Në këto rrethana, me të drejtë në rubrikën "masa e dënimit me burgim" kandidati Qerim Ismailaj ka deklaruar detyrimin e caktuar nga gjykata për kryerjen e punës në interes

publik, detyrim i cili ka zëvendësuar dënimin me burgim. Për pasojë, deklarimi përkatës është plotësisht i vërtetë, i saktë, i plotë dhe përputhet me të dhënat e vendimit të dënimit të Kandidatit Qerim Ismailaj, ndaj nuk lind nevoja e kryerjes së verifikimeve të tjera të thelluara dhe nuk mund të përbëjë kjo shkak për të vënë në diskutim lejimin për të kandiduar të këtij shtetasi.

- Duke vijuar më tej me analizën e pretendimeve të parashtruara në ankim, evidentojmë se është e vërtetë se formulari është plotësuar e nënshkruar nga vetë kandidati i cili ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e plotësimit të këtij akti, ndaj me përgjegjshmëri maksimale ka përmbushur detyrimin e tij ligjor duke deklaruar në mënyrë të plotë, të vërtetë e të saktë të gjitha faktet dhe rrethanat. Duke u bazuar në të dhënat e këtyre fakteve e rrethanave, të analizuar në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 138/2015, Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 dhe dispozitave të zbatueshme të Kodit Penal, rezulton plotësisht i drejtë e i bazuar Vendimi Nr. 366 datë 15.04.2023 i KSHZ në pjesën që ka disponuar mospranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike për moslejimin e kandidimit të kandidatit Qerim Ismailaj si kryetar në Bashkinë Mallakastër për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

- Parashikimet e nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 ndalojnë kandidimin për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik, ku përfshihet dhe kandidimi për kryetar bashkie, të personit që është dënuar me jo më pak se gjashtë muaj burgim për kryerjen me dashje të një krimi. Kurse parashikimet e pikave 4 e 9 të nenit 4 të ligjit në fjalë përcaktojnë mënyrën se si zbatohet kufizimi i përcaktuar në germën "ç" të pikës 1 të nenit 2. Ndalimi për këtë kategori personash zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim, deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal. Më tej, pika 9 ka përjashtuar nga llogaritja në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit të disa përfitimeve ligjore që passjellin shkurtimin e masës së dënimit me burgim, e për pasojë zvogëlojnë edhe periudhën e ndalimit, siç janë ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit. Por, nuk konstatohet që parashikimet e kësaj dispozite të përjashtojnë nga llogaritja në funksion të përcaktimit të ndalimit të rastit të zëvendësimit të dënimit me burgim me detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal. Një fakt i tillë nuk është rastësor.

- Parashikimet e pikës 4 të nenit 4 të ligjit kanë përcaktuar përfundimin e periudhës së ndalimit të kandidimit me plotësimin e afateve të rehabilitimit, sipas përcaktimeve në nenin 69 të Kodit Penal. Parashikimet e kësaj dispozite janë të lidhura me përcaktimin e afateve të caktuara që duhet të kalojnë nga momenti i vuajtjes së dënimit, periudhë gjatë të cilës i dënuari nuk duhet të kryejë veprë tjetër penale, në mënyrë që personi i dënuar të mos konsiderohet më si i tillë. Por, parashikimet e kësaj dispozite nuk janë të lidhura me parashikimet e nenit 63 të Kodit Penal, i cili ka përcaktuar se në alternativën e parashikuar nga vetë kjo dispozitë, dënimi me burgim konsiderohet i paqënë, e për pasojë personi konsiderohet i padënuar, që nga momenti i përmbushjes së detyrimit të vendosur nga gjykata për kryerjen e orëve të caktuara të punës në interes publik pa pagesë dhe brenda afateve e kushteve që ka përcaktuar gjykata dhe vetë dispozita në fjalë. Pikërisht, ky është përjashtimi që bëjnë parashikimet e nenit 63 të Kodit Penal nga rregulli i përgjithshëm i rehabilitimit që parashikon neni 69 i këtij Kodi, duke e konsideruar personin e dënuar të rehabilituar menjëherë pas plotësimit të orëve të punës në interes publik.

- Në rastin e kandidatit Qerim Ismailaj konstatohet se vendimi nr. 11 datë 02.02.2023 të GJKKO është vënë në ekzekutim pa prituri që ai të merrte formë të prerë dhe ky shtetas provohet të ketë përfunduar detyrimin e përcaktuar në këtë vendim në periudhën 22.02.2023 deri më 28.02.2023, duke punuar për 40 orë. pa pagesë, pranë ambienteve të Muzeut Historik Fier. Një fakt i tillë vërtetohet nga shkresa nr. 195/3 prot, datë 09.03.2023 e Degës Territoriale të Shërbimit

të Provës Fier, si dhe Vendimi i datës 09.03.2023 i prokurorit të Prokurorisë së Posaçme "Mbi përfundimin e dënimit alternativ për të pandehurin Qerim Ismailaj" i cili i është njoftuar këtij shtetasi me shkresën nr. 428/6 Prot, Q.SH. datë 10.03.2023. Me këtë vendim prokurori ka konsideruar të kryer dënimin alternativ të dhënë nga GJKKO për shtetasin Qerim Ismailaj me vendimin penal përkatës. Në mënyrë të shprehur në pikën 2 të këtij vendimi, prokurori ka disponuar: "2. Me përfundimin e punës nga i pandehuri Qerim Ismailaj, dënimi konsiderohet i paqenë." Pra, vetë prokurori me vendimin e konstatimit të përfundimit të dënimit alternativ ka deklaruar edhe humbjen e pasojave të dënimit duke përcaktuar se konsiderohet i paqenë, e për pasojë shtetasi Qerim Ismailaj konsiderohet i padënuar.

- Nga gjithë sa u arsyetua më sipër, konstatohet se pretendimet e parashtruara në padi nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë plotësisht të pabazuara në rrethanat e faktit e të ligjit. Kandidati Qerim Ismailaj ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, Kodit Penal dhe Kodit Zgjedhor, duke deklaruar hollësisht në këtë formular të dhëna të plota. të qarta dhe që përputhen me realitetin. Duke u bazuar në këto të dhëna është qartësisht e dukshme se kandidati në fjalë nuk ndodhet në asnjë prej kushteve të ndalimit të përcaktuara në nenin 2 të ligjit Nr.138/2015, ndaj me të drejtë Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, me vendimin nr.366 datë 15.04.2023 ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike për moslejimin e kandidimit për këtë kandidat.

- Për sa më sipër, bazuar në nenin 145 të Kodit Zgjedhor; nenet 2, 4 e vijues të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Vendimin nr.17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pala e interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë kërkon rrëzimin e padisë së paditësit Partia Demokratike e Shqipërisë, si të pabazuar në ligj e prova".

ARSYETIMI I KOLEGJIT

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë paraprakisht faktin se, procesi administrativ pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, disponimet e organeve të të cilit rezultojnë të jenë bërë objekt i padisë së paraqitur për shqyrtim, lidhet me zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe dispozitave të Kodit Zgjedhor, që diktojnë zbatimin e këtij ligji.

Konkretisht, Neni 19/1,n i Kodit Zgjedhor, parashikon se:

"1. Komisioneri ka këto kompetenca:...

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it".

Neni 5 i Ligjit Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", parashikon se:

"1. Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.

2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosëmërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

3. Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt i këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.

4. Formulari i vetëdeklarimit dorëzohet dhe administrohet, sipas rastit:

a) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore; ...”.

Sikurse evidentuam edhe në pjesën përshkuese të vendimit, bazuar në dispozitat e sipërcituara, më datë 01.04.2023, rezulton të jetë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për kandidatin Qerim Ismail Ismailaj, Formulari i Vetëdeklarimit Nr.UNIK FR-PS-16657.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, qendrimin e tij mbi lejimin e shtetasit Qerim Ismailaj, për të kandiduar për kryetar në Bashkinë Mallakastër, për zgjedhjet e organet të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton ta ketë formalizuar në dy raste.

Së pari: Pas kryerjes *ex officio* të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kryetar bashkie për kandidatët e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në disa bashki, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.300 Dt.05.04.2023 “Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, që konsiston në:

“-Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie, të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për disa bashki dhe lejimin e kandidimit të tyre.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet **Kërkesës Ankimore Nr.48 Dt.07.04.2023**, rezulton t'i ketë kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve:

- Shfuqizimin pjesërisht të Vendimit Nr.300 Dt.05.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

- Ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës, shtetasit Qerim Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë disponuar në këtë rast, Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023, që konsiston në mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore, bazuar ndër të tjera, në argumentin se:

“4...KAS-i rikonfirmon kompetencën e tij ligjore për shqyrtimin e këtij ankimimi dhe të çdo ankimimi ndaj vendimeve të Komisionerit të dala në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

5. Pika 7 e nenit 3 të KPrA jep përkufizimin e palës në një procedurë administrative. Sipas kësaj pike “Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj të ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

6. Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” nuk është në kushtet e pikës 1 të nenit 33 të KPrA, sepse ai nuk është subjekt që ka kërkuar fillimin e procedurës administrative, sikurse nuk është subjekt ndaj të cilit të ketë filluar procedura, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi nr.300, datë 05.04.2023.

9. Ankuesi solli në vëmendje të KAS-it, në mbrojtje të argumentave të veta lidhur me legjitimitimin aktiv të tij, procedurën administrative të zhvilluar nga KAS-i në rastin e vendimit nr.101, datë 07.07.2021. Në vlerësimin e KAS-it kjo procedurë provon të kundërtën e pretendimeve të ngritura nga ankuesi. Vendimi nr.101, datë 07.07.2021 i përket një procedure të vënë në lëvizje nga Partia Demokratike, sikurse u pohua nga përfaqësuesi i ankuesit në seancë. Atëkohë Partia Demokratike kishte paraqitur kërkesë pranë Prokurorisë së Përgjithshme (data 09.01.2020) me objekt “Verifikimi i pastër i figurës së shtetasit Qerim Ismaili”, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe më pas kishte ndjekur procedurat e shqyrtimit administrativ. Atëkohë ankuesi kishte vepruar në kushtet e palës me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative (shkronja “a” e pikës 1 të nenit 33 të KPrA). Procedura e e vendimit nr.300, datë 05.04.2023 është procedurë e nisur ex officio”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, nëpërmjet Vendimit Nr.53 Dt.10.04.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë konfirmuar standardin lidhur me legjitimitimin formal të një subjekti për ta investuar këtë organ me kërkesë ankimore, duke identifikuar si të tillë:

- Subjektin që ka kërkuar fillimin e procedurës administrative;
- Subjektin ndaj të cilit ka filluar procedura administrative.

Në këtë kontekst, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë konkluduar mbi moslegjitimitimin formal të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përse kohë konstatonte se, Vendimi Nr.300 Dt.05.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk ishte:

- as rezultat i një procedure administrative, të nisur nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- as rezultat i një procedure administrative, të nisur ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Por, pavarësisht këtij konstatimi që përligjte të drejtën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për të mos vijuar më tej me marrjen në analize edhe të legjitimitit substancial/material të ankuesit, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, nëpërmjet Vendimit Nr.53 Dt.10.04.2023, është analizuar dhe konkluduar gjithashtu se:

“7. Pikat 2 dhe 3 të nenit 33 të KPrA kërkojnë që një subjekt pa interesa të drejtpërdrejta në një procedurë administrative të mund të përfshihet si palë duhet të demonstrojë se të drejtat apo interesat e saj të ligjshme mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative. Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” nuk provoi dot në seancë cënimin e asnjë interesi të ligjshëm nga vendimi nr.300, datë 05.04.2023. Vendimi ka lidhje me kandidatët e një subjekti tjetër zgjedhor, ndërkohë që kandidati i ankuesit, i regjistruar në garën për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Mallakastër, nuk rrezikon të çrregjistrohet nga gara për shkak të vendimit nr 300, datë 05.04.2023.

8. Ankimi i subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” ndaj vendimit të Komisionerit nr.300, datë 05.04.2023 kërkon që KQZ-ja të ndalojë kandidatin për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” për bashkinë Mallakastër të konkurrojë në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Në kushtet kur kandidati Qerim Ismailaj është regjistruar në zgjedhje me vendimin nr.04, datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr.62, kërkesa de facto kërkon çregjistrimin nga pjesëmarrja në zgjedhje të kandidatit të një subjekti tjetër zgjedhor. Interesi për çregjistrimin e kandidatit të një subjekti tjetër nga zgjedhjet është interes i cilësuar jo legjitim jo vetëm nga KAS-i në disa vendimarrje të mëparshme (vendimi i fundit, vendimi nr. 40, datë 03.04.2023), por edhe nga kolegji zgjedhor në vendimin e tij nr.1, datë 09.05.2019. “Fakti që një subjekt zgjedhor regjistrohet në zgjedhje dëshmon se interesat e tij të ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për çregjistrimin e një tjetër subjekti zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor”, thuhet në vendimin e sipërcituar të kolegjit zgjedhor”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, praktika e Kolegjit ku rezulton të jetë referuar në këtë rast Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (Vendimi Nr.1 Dt.09.05.2019), konfirmon qendrimin se:

“Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor, çmoi së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv.

Lidhur me legjitimitetin aktiv, Gjykata e Apelit çmon se: që padia të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi dhe b) legjitimiteti për të vepruar.

Në rast se ekzistojnë këto dy kushte mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, për të pranuar apo rrëzuar atë. Në lidhje me interesin e ligjshëm për të ngritur padi, Gjykata çmon se, interesi për të ngritur padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi, është një interes procedural dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është cënuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese.

Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Interesi për të ngritur padi i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të cënuar.

Në nenin 145 të Kodit Zgjedhor parashikohet se:

“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në kolegjin zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të K.Q.Z-së kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshme brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor”.

Në rastin në shqyrtim shtohet pyetja cili është interesi i ligjshëm i paditësit Partia Bashkimi Demokrat dhe a i është cënuar interesi i ligjshëm, çfarë cënimi i është shkaktuar palës paditëse?

Në momentin e regjistrimit pranë K.Q.Z. çdo subjekt zgjedhor, kryen këtë veprimtari me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cili subjekt do të marri pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre në këto zgjedhje.

Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm nëse nga K.Q.Z, ky subjekt do të regjistrohej apo jo, pas kërkesës që ai do t'i bënte K.Q.Z-së.

Paditesi si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga K.Q.Z si i tillë për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij.

Regjistrimi nga K.Q.Z i çdo subjekti apo mosregjistrimi i tij nuk cënon interesat e subjekteve të tjerë të cilëve u është pranuar ose jo regjistrimi si subjekt zgjedhor.

Subjekti zgjedhor përfshi dhe partitë politike, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet që do të regjistrohen nga K.Q.Z.

Fakti që një subjekt zgjedhor regjistrohet në zgjedhje dëshmon se interesat e tij të ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për çregjistrimin e një tjetër subjekti zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interesa të ligjshme të subjektit zgjedhor, si kusht për ngritjen e kësaj padie në bazë të nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

Kërkesa për çregjistrimin e Bindjes Demokratike nga paditësi Bashkimi Demokrat, është kërkesë që nuk përmbush interesa të ligjshme të asnjë subjekti përfshirë dhe vetë partinë bashkimi Demokrat, për shkak se kjo kërkesë cënon një nga kriteret kryesorë atë të konkursshmërisë së procesit zgjedhor.

Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo subjekti zgjedhor nuk cënon interesat e ligjshme të paditësit.

Në vlerësimin e Kolegjit Zgjedhor pala paditëse nuk gëzon legjitimitetin aktiv pasi nuk cënohen interesat e tij të ligjshme siç mund të jenë edhe kushtet e zhvillimit të zgjedhjeve.

Rregjistrimi i subjektit “Bindja Demokratike” nga K.Q.Z (vendimi nr. 230 dt. 27.04.2019), nuk ndryshon kushtet e konkurimit për subjektet e tjera zgjedhore e në kushtet e mësipërme paditësi nuk gëzon legjitimitet për të kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 230 dt. 27.04.2019 të K.Q.Z.

Në nenin 153/1/c të Kodit Zgjedhor përcaktohet se palë të interesuara janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë K.Q.Z.

Në rastin konkret pala paditëse nuk është palë pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ të K.Q.Z. (vendimi nr. 230 dt. 27.04.2019)”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, nëpërmjet kësaj praktike, rezulton të jenë marrë në analizë (edhe pse jo në rend kronologjik), legjitimimi formal dhe ai substancial/material, duke vendosur standardin sipas të cilit:

- subjekti ankues legjitimohet formalisht, vetëm kur konfirmohet të ketë qenë pikërisht ai, iniciuesi i procedurës administrative;
- subjekti ankues legjitimohet substancialisht/materialisht vetëm nëse ai, si subjekt që ka vënë në lëvizje procedurën administrative, provon se nëpërmjet vendimmarrjes respektive, i janë cënuar interesat në bazë të Nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, Partia Demokratike e Shqipërisë e ka ankimuar në Kolegji, Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe se gjykimi është pushuar me Vendimin Nr.15 Dt.24.04.2023, për shkak të heqjes dorë nga gjykimi.

Së dyti: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në Kërkesën Dt.06.04.2023 të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për: “verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z.Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar Bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Mallakastër”, ka disponuar Vendimin Nr.366 Dt.15.04.2023, që konsiston në:

“1.Mospranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike për mos lejimin e z.Qerim Ismailaj për të kandiduar si kandidat për kryetar në Bashkinë Mallakastër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet **Kërkesës Ankimore Nr.49 Dt.17.04.2023**, rezulton t’i ketë kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve:

- Shfuqizimin e Vendimit Nr.366 Dt.15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z.Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

- Ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës, shtetasit Qerim Ismail Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë disponuar në këtë rast Vendimin Nr.60 Dt.19.04.2023 (pasqyruar i plotë në pjesën përshkuese të vendimit tonë), që konsiston në rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të Vendimit Nr.366 Dt.15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, edhe në këtë rast, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë marrë në shqyrtimin paraprakisht, çështjen e legjitimitimit formal, duke konkluduar lidhur me të, se:

“1.Ankuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa legjitimohet në të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.366, datë 15.04.2023, duke qenë se është pala që ka vënë në lëvizje procedurën administrative në cilësinë e kërkuarit”.

Pra, nëpërmjet këtij përfundimi konstatohet që Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve të ketë konfirmuar standardin e reflektuar edhe në Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023, lidhur me legjitimitimin formal të ankuesit.

Por, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se, në Vendimin Nr.60 Dt.19.04.2023 (objekt padie), lidhur me legjitimitimin substancial/material, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka konkluduar se:

*“2. Nisur nga objekti i saj, kërkesa ankimore nr.49, e datës 17.04.2023 e ankuesit Partia Demokratike e Shqipërisë hyn në sferën e kompetencës së KAS-it. **Kodi Zgjedhor njeh ankimimin administrativ si mjet ligjor për mbrojtjen e interesave të ligjshme, sepse i ka njohur KAS-it***

kompetencën për të shqyrtuar dhe zgjidhur në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit (shkronja “ b” e pikës 1 të nenit 21, pika 2 e nenit 124/1 të KZ)”.

Përkundër sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, konfirmimi nëpërmjet dispozitave të Kodit Zgjedhor, i kompetencës së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për të shqyrtuar dhe zgjidhur në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit, nuk përbën rrethane që konfirmon automatikisht për këtë shkak, legjitimimin substancial të subjektit ankues.

Kjo mënyrë të arsyetuar e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve lidhur me legjitimimin substancial, nuk përputhet me standardin e vendosur nga ky organ në rastin e marrjes në analizë të këtij elementi në Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023 (cituar më lart).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, lidhur me legjitimimin substancial do të duhej të kishte analizuar të njëjtat çështje që rezultoi të kishte analizuar për të njëjtin qellim, edhe në Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023 e që konsistojnë në:

- cenimin ose jo të ndonjë interesi të ligjshëm të ankuesit, nga Vendimi Nr.366 Dt.15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- të pasurit ose jo lidhje të kandidatit Qerim Ismailaj, me subjektin ankues (PDSH), apo me ndonjë subjekt tjetër, pjesëmarrës në zgjedhje;
- regjistrimin apo refuzimin e regjistrimit të kandidatit të ankuesit, në garën për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Mallakastër;
- ekzistencën ose jo të rrezikut të çregjistrimit nga gara, të kandidatit të ankuesit, për shkak të Vendimit Nr.366 Dt.15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- të qenurit të pazbatueshëm në këtë rast, të Vendimit Nr.1 Dt.09.05.2019, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon të nevojshme të evidentojë gjithashtu faktin se, çështja e legjitimitimit substancial/material:

- nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga personi i interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë gjatë shqyrtimit administrativ, por lidhur me të rezulton të jenë ngritur prapsime, vetëm gjatë gjykimit para Kolegjit (të pasqyruara më lart);
- nuk rezulton të jetë sqaruar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, standardi i vendosur prej tij, duke mos e bërë të kuptueshme në këtë rast, arsyen e legjitimitimit substancial të ankuesit;
- nuk rezulton të jetë saktësuar në përmbajtjen e kërkespadiës, objekt shqyrtimi.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, çështja e legjitimitimit substancial/material, lipset analizuar në bazë të Nenit 145 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

“E drejta e ankimit në gjykatë.

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar, e drejta e ankimit në gjykatë u përket:

- individëve apo partive politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor;
- individëve apo partive politike të cilëve, pavarësisht se nuk u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, u janë cenuar interesat e tyre të ligjshëm nga vendimet e KQZ-së.

Në rastin në shqyrtim, kandidati i paditësit/ankuesit Partia Demokratike e Shqipërisë, rezulton të jetë regjistruar në garën për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Mallakastër.

Në këtë kontekst, lipset analizuar interesi i ligjshëm që i cenohet paditësit, nga Vendimi Nr.366 Dt.15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Sikurse evidentuam edhe më lart, për shkak mosparashtrimi në kërkespadi, të argumentave lidhur me legjitimitimin substancial, mbi kërkesën e Kolegjit, ankuesi sqaroi në seancë gjyqësore se, cenimi i interesit të ligjshëm konsistonte në këtë rast në faktin se, lejimi i kandidimit të shtetasit Qerim Ismailaj, nuk krijonte kushte të barabarta pjesëmarrje në zgjedhje.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në logjikën e këtij argumenti vlerëson se, pabarazia e kushteve të pjesëmarrjes në garën për kryetar të Bashkisë Mallakastër, konsiston në faktin se, përkundër subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë që garon, sipas ankuesit, me një kandidat me precedent penal ndalues, kandidati i ankuesit nuk e ka këtë problematikë.

Duke mos rënë dakord me këto logjike, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor terheq vemendjen mbi faktin se, çështja e legjitimitimit substancial të nje subjekti të cilit nuk i është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, lipset marre ne analize edhe ne raport me dispozitat e Ligjit, Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, sa here që procesi administrativ lidhet me zbatimin e tyre, sikurse në rastin konkret.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, Neni 1 i Ligjit Nr.138/2015, parashikon se:

“1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

2. Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji”.

Në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor tërheq vëmendjen mbi faktin se, asnjë subjekt zgjedhor (pra që i është pranuar kërkesa për t'u regjistruar si pjesëmarrës në zgjedhje), nuk mund të investojë Komisionerin, KAS-in apo Kolegjin, me një ankesë/padi që synon mbrojtjen e një interesi publik, sikurse është moslejimi i zgjedhjes së personave të dënuar apo mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit të institucioneve kushtetuese.

Në këtë kontekst, argumenti i parashtruar nga paditësi në seancë gjyqësore se, në garë zgjedhore nuk mund të lejohet kandidimi i një personi që nuk plotëson kushtet e Ligjit Nr.138/2015, konfirmon të vepruarit e paditësit për një interes publik dhe njëherësh mungesën e interesit të tij si subjekt zgjedhor, për të rivendosur me ndërhyrjen e Kolegjit, një interes vetjak të shkelur, përsa kohë një i tillë nuk ekziston.

Në vlerësimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të bërit e dallimit ndërmjet interesit publik dhe atij personal, do të duhej të kishte diktuar ndjekjen nga paditësi të procedurave për dorëzimin e kallëzimit penal ndaj shtetasit që, sipas tij, ka plotësuar formularin e dekriminalizimit në shkelje të dispozitave ligjore.

Ky përfundim bazohet pikërisht në argumentat e vëna në themel të padisë, se:

“- Nga analiza e fakteve të mësipërme, rezultojnë dy konkluzione të rëndësishme të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me vlerësimin që KSHZ duhet të bënte lidhur me vijueshmërinë e kandidimit ose jo te shtetasit Qerim Ismailaj ne zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Kjo është një situatë ligjore, sipas së cilës, detyron këdo, që vihet në dijeni të këtij fakti, e me së pari autoritetin shtetëror të ngarkuar nga ligji, të bëjë verifikimet përkatëse (në këtë rast KSHZ), që të ezauroje menjëherë, paraqitjen e kallëzimit penal pranë prokurorisë përkatëse.

- Konkluzioni i dytë: shtetasi Qerim Ismailaj, i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, pranë KZAZ nr.62 Mallakastër, duhet të ndalohet të kandidojë, për shkakun se sipas parashikimeve të ligjit 138/2015 "Për dekriminalizimin..." rezulton se bie brenda sferës së aplikimit të këtij ligji”.

Për sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, pavarësisht shkaqeve të ngritura në padi, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, sikurse në Vendimin Nr.53 Dt.10.04.2023, do të duhej të kishte disponuar edhe në këtë rast, mbi mospranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore Nr.49 Dt.17.04.2023, të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, për mungesë legjitimitimi substancial/material.

Përfundimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor mbi mungesën e legjitimitimit substancial/material të palës paditëse, dikton mosmarrjen në shqyrtim të argumentave të vëna në themel të vendimit të KAS (objekt padie) dhe të kundërshtuara me padi, për të cilat u debatua në mënyrë të panevojshme, edhe në seancë gjyqësore.

Shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje përbëhen nga taksa mbi aktet, në masën 3000 (tre mijë) lekë, parapaguar nga paditësi.

Shpenzime të tjera nuk u kryen dhe as u pretenduan.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158/3 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash:

V E N D O S I :

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më datë 24.04.2023.

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTARE
Emona MUÇI

GJYQTARE
Blerona HASA

GJYQTARE
Marsela DERVISHI

GJYQTARE
Manjola XHAXHO
(kundër)